



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

OSNOVNI SUD GNJILANE

Numri i lëndës: 2022:231077
Datë: 25.01.2023
Numri i dokumentit: 03902502

CP.nr.997/2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Milorad Mitković, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në lëndën përbarimore të kreditores J.S. nga fshati Sh.K.Gj. të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Faruk Brestovci avokat nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Gjilanit- Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, lidhur me kompensimin e të ardhurave personale, sipas dokumentit përbarimor, aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.783/15 të datës 20.04.2018 si dhe Akgjykimit të ndryshuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë sa i përket kamatës Ac.nr.3549/18 të dt.08.12.2021, jashtë seance gjyqësore, në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), më datë 23.01.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Urdhërohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave – Thesari në Prishtinë, që mjetet monetare nga xhirollogaria e debitorit Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit Gjilan, që në emër të kompensimit të të ardhurave personale, t'i paguhet shuma prej 2,563.00 euro (së bashku me kamatën ligjore, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, dhe përbarimore shumë e përgjithshme prej 2,954.00 euro (dymijë e nëntëqindë e pesëdhjetë e katër euro), t'i bartet të autorizuarit të kreditores, av.Faruk Brestovci nga Gjilani, në xhirollogarinë: 1406000005979494 në Bankën Ekonomnike në Gjilan, pasi që aktvendimi mbi caktimin e përbarimit CP.nr.997/22 i datës 08.11.2022, është bërë i ekzekutueshëm nga data 23.11.2022 në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

II. Pika I e këtij dispozitivi e ka efektin e aktvendimit mbi caktimin e përbarimit me të cilin është caktuar sekuestrimi i kredisë në të holla të debitorit dhe kalimi i saj për arkëtim në dobi të kreditorit në kuptim të nenit 152 të Ligjit për Procedurën Përbarimore.

III. Aktvendimi i dorëzohet palëve ndërgjyqësore, Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave-Thesarit në Prishtinë, ndërsa një ekzemplar mbetet në lëndë.

A r s y e t i m

Kreditore, përmes të autorizuarit të tij më datë 01.11.2022, ka parashtruar propozim për përmbarrim kundër debitorit, lidhur me pagesën në emër kompensimit të të ardhurave personale, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.783/15 të datës 20.04.2018 si dhe Aktgjykimit të ndryshuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë sa i përket kamatës Ac.nr.3549/18 të dt.08.12.2021, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 2,098.00€ (dymijë e nëntëdhjetë e tetë euro).

Duke vepruar sipas këtij propozimi, gjykata ka lejuar të njëjtin dhe një kopje i ka dërguar debitorës, dhe kjo e fundit në afatin ligjor nuk ka paraqitur kundërshtim dhe më pas gjykata ka caktuar ekspertin financiar, për të llogaritur kamatën ligjore.

Me datë 13.12.2022, gjykata ka pranuar ekspertizën financiare, ku eksperti për periudhën prej 20.04.2018 e deri mëd atën 13.12.2022 për shumën e aprovuar prej 2,089.00€, kamatën prej 8 %, ka paraqitur shumën prej 776 €. Ekspertizës financiare gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që eksperti në fjalë (Gëzim Jusufi) ka një përvojë të gjatë në përpilimin e konstatimeve të saja.

Sa i përket shpenzimeve, Gjykata llogariti shumën prej 391 euro, edhe atë, në emër të procedurës kontestimore shumën prej 155 euro,(sipas aktgjykimit i cili përmbarrorhet), shumën prej 156 euro për shpenzimet e procedurës përmbarrimore, për taksë gjyqësore shumën prej 30 € si dhe në emër të Ekspertizës shumën prej 50 euro, pasi që debitori nuk ka paguar në afatin e paraprë kreditorit dhe këto shpenzime janë krijuar pa vullnetin e këtij të fundit.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, pasi në nenin 14, paragraf 2 të LPP-së, lidhur me nenet 144 deri 156 nga Kreu IV i po këtij ligji nuk është paraparë paraqitja e ankesës kundër aktvendimit me të cilin urdhërohet banka ose ndonjë institucion tjetër përkatës, siç kemi të bëjmë me rastin konkret si në dispozitiv të këtij aktvendimi të bazuar në dispozitat e nenit 152 të LPP-së, përkitazi me përmbarrimin për kredinë sipas llogarisë në bankë. Arkëtimi lëndor i kredisë në të holla nga ana e subjekteve të caktuara siç kemi të bëjmë me rastin konkret, është rregulluar me nenin 40 të LMFPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
CP.nr.997/2022, më datë 23.01.2023

Gjyqtari,
Milorad Mitković

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2022:231077
Datë: 25.01.2023
Numri i dokumentit: 03902502